

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2007

Viti 2007 shënoi rezultate më të larta krahasuar me vitin e kaluar si në veprimtarinë bibliotekare, realizimin e shërbimeve, ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, që ishin të larmishme dhe të shumta. Edhe këtë vit nuk mungoi mbështetja e Drejtorisë për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës për pasurimin e fondit të koleksioneve me libra të rinj, të përzgjedhur në bazë të kërkesave të përdoruesve. Kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të anëtarësuarve në krahasim me vitin e kaluar. Në këtë raport është paraqitura e gjithë veprimtaria bibliotekare dhe aktivitetet kulturore që janë zhvilluar gjatë vitit 2007 në bibliotekën ndërkomunale “Hivzi Sylejmani të Prishtinës.

Punët profesionale

Përveç punëve profesionale si: përpunimi i librit, klasifikimi, katalogimi, printimi, puna me lexues etj., të cilat janë kryer në mënyrë profesionale. Janë përpunuar të gjithë librat që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti si dhe janë hartuar projekte për pasurimin e fondeve të bibliotekës dhe degëve të saj, janë mbledhur dhe hartuar raportet dhe programet vjetore të punës që janë shqyrtuar dhe analizuar në Kolegjin profesional të bibliotekës dhe janë dhënë sugjerime e propozime për ngritjen e efikasitetit të punës.

Gjatë këtij viti është bërë përpunimi 801 titujve dhe 3398 ekzemplarëve të koleksioneve të bibliotekës së sh. F. “Dardania” Gjithashtu janë përpunuar edhe 115 tituj me 628 ekzemplarë të koleksioneve të bibliotekës së sh. F. “Nazmi Mustafa” në Besi.

Të gjitha këto punë i ka kryer një ekip profesionist i bibliotekës sonë.

Koordinimi i punës me bibliotekat komunale

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare në bibliotekat komunale në Lypjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Besianë dhe Drenas, mbikëqyrjen profesionale të të cilave, bazuar në Ligjin për biblioteka, e ka për detyrë biblioteka jonë, gjatë këtij viti ka pasur kontakte, konsultime rreth punës profesionale dhe organizimit të sektorëve.

Me një projekt të iniciuar nga Biblioteka jonë e cila u dërgua edhe në Ministri për Kulturë Rini dhe Sport, disa ekspertë të kësaj biblioteke me 26 shkurt të këtij viti filluan një inspektim profesional në bibliotekat komunale të: Lypjan, Kastriot, Drenas, Besianë dhe Fushë Kosovë. Qëllimi i këtij projekti ishte që përmes vizitave dhe inspektimit të punëve profesionale të këtyre bibliotekave të shikohet sa respektohen parimet e IFLA-s për veprimtarinë bibliotekare si dhe respektimi i KDU. Së pari kemi filluar në Lypjan me 26 shkurt, pastaj në Kastriot me 27 shkurt pastaj është vazhduar nëpër bibliotekat tjera komunale. Pas përfundimit të vizitave në 5 bibliotekat komunale të cilat u cekën më lartë do të shihet sa respektohen këto parime dhe në bazë të vërejtjeve nga fusha të ndryshme do të

shikohet mundësia e mbajtjes së një seminari 2 ditor me punëtorët e këtyre bibliotekave gjatë këtij viti me qëllim të unifikimit të veprimtarisë bibliotekare dhe respektimit të rregullave të caktuara për të gjithë.

Me 26-27 qershor Seminari u mbajt në lokalet e degës “Biblioteka Përkujtimore” ku morën pjesë librarët e të gjitha bibliotekave komunale dhe doli shumë i suksesshëm. Ligjëratat i mbajtën profesionistët e bibliotekës sonë ku u përfshi e gjithë veprimtaria bibliotekare prej përpunimit fizik e deri tek koha kur libri shkon në huazim. Përveç ligjëratave pati edhe ushtrime ku morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit.

Përkrahja e Bibliotekës komunale të Lypjanit me periodik-gazeta dhe revista të ndryshme nga fondi rezervë i disa viteve me radhë që Biblioteka i merr falas dhe një sasi marrë kohë më parë prej MKRS, Divizionit të Promovimit (Epoka e re, Lajm, Iliria Post, Gjurmime albanologjike, Gjuha jonë, Jeta e re etj.).

Seminaret

- Pas një inspektimi bibliotekave komunale të cilat i mbikëqyrim doli i nevojshëm mbajtja e një seminari me punëtorët e këtyre bibliotekave me qëllim të unifikimit të veprimtarisë bibliotekare. Seminari u mbajt me 25-26 qershor në lokalet e degës “Biblioteka Përkujtimore” ku morën pjesë librarët e të gjitha bibliotekave komunale dhe doli shumë i suksesshëm. Ligjëratat i mbajtën profesionistët e bibliotekës sonë ku u përfshi e gjithë veprimtaria bibliotekare prej përpunimit fizik e deri tek koha kur libri shkon në huazim. Përveç ligjëratave pati edhe ushtrime ku morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit.
- Me 12-13 prill 2007, organizuar nga biblioteka ndërkomunale e Prizrenit, u mbajt një seminar dyditor me tema profesionale nga bibliotekaria . Seminari i dedikohet punëtorëve të bibliotekave komunale , por morën pjesë edhe bibliotekarë profesionist nga bibliotekat ndërkomunale të Kosovës. Punëtorët e bibliotekës sonë ndihmuan shumë në rrjedhën e mbarë të seminarit dhe e patën barrën kryesore të ligjëratave. Përveç ligjëratave nga punët profesionale në bibliotekë pati edhe ushtrime dhe diskutime të ndryshme rreth kësaj veprimtarie.

Trajnimet

- Gjatë kësaj periudhe në bibliotekën tonë janë trajnuar për punët profesionale të bibliotekës 6 punëtorë: një nga sh. f. Dardania”, një nga sh. f. N. Mustafa” në Besi, një nga Lypjani dy nga Fushë Kosova dhe një nga Presheva. Ata morën njohuri të përgjithshme për punën me lexues, klasifikimin dhe katalogimin. Gjithashtu edhe material profesional që do tu duhet në të ardhmen.
- Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës doli me një projekt shumë të rëndësishëm: shpërndarjen falas të një moduli të programit Aleph bibliotekave ndërkomunale. Ky projekt pritet të realizohet shumë shpejtë prandaj në BKUK u

mbajt një trajnim 10 ditor për përvetësimin e punës së programit, ku morën pjesë nga dy punëtorë nga secila bibliotekë ndërkomunale. Ky trajnim u mbajt me 22 tetor deri më 2 nëntor 2007.

- Punëtorë të bibliotekave ndërkomunale, gjithsej 25 veta morën pjesë në Konferencën e Kobis-it 2007 për bashkëpunim ndërkulturorë, e cila u mbajt me 28-29 nëntor në Maribor. Me tema u paraqitën shumica e vendeve pjesëmarrëse.
- 14-25 maj një grup prej 20 bibliotekarësh patën një trajnim nëpër bibliotekat e Sllovenisë. Nga biblioteka jonë morën pjesë Fatime Mehmetaj dhe Xhemal Luta. Java e parë përmbante vizita monumenteve kulturore të Sllovenisë dhe ligjërata profesionale, kurse java e dytë trajnim në një bibliotekë për tu njohur me të arriturat e bibliotekarisë në Slloveni si dhe me programin për biblioteka Kobis.

Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe periodikut

Viti 2007 sa i përket pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj, ishte shumë më i pasur se vitin e kaluar. Edhe këtë vit pati mirëkuptim dhe mbështetje nga Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës. Për të pestën herë me radhë ajo po kontribuon në pasurimin e koleksioneve me libra të rinj. Këtë herë ka financuar një projekt me vlerë 13.133 €. Projekti është realizuar në fund të këtij viti dhe përmban 447 tituj me 3148 kopje librash.

Vlen të përmendet edhe shfrytëzimi i rastit gjatë mbajtjes së Panairit të Librit në maj të këtij viti në Prishtinë, ku Biblioteka me të hyrat e saja nga anëtarësimi, bleu dhjetëra tituj dhe disa qindra libra për të pasuruar fondin e koleksioneve në vlerë mbi 2000 € si dhe në Panairin e librit në Tiranë ku u ble një sasi librash.. Në këtë formë janë blerë edhe dhjetëra libra të tjerë nga autorë të vendit. Edhe institucione dhe individë i kanë dhuruar libra kësaj biblioteke. Në vitin 2007 kanë hyrë në bibliotekë gjithsej 1084 tituj me 5933 kopje të librave. Prej tyre, libra të blerë 7721 tituj me 4725 kopje dhe libra të dhuruar me 259 tituj që bëjnë 965 kopje.

Gjithashtu furnizimi me periodik ishte në nivel. Në bibliotekën qendrore janë marrë 5 gazeta të përditshme, të cilat u janë në shërbim të lexuesve: “Koha ditore“, “Zëri“ „Epoka e re“, “Lajmi”, “Bota Sot” ; radhës së revistave tashmë i është shtuar edhe revista letrare “Oaza” që e boton kjo bibliotekë. Sikurse viteve të tjera, u bë lidhja e tri gazetave ditore: ”Bota sot”,”Koha ditore“, dhe “Zëri”. Gazeta “Bota sot” një periudhë nuk është botua por del rregullisht. E marrim rregullisht falas revistën “Kosovarja”

Aktivitete bibliotekare dhe kulturore

- Java e bibliotekës në Kosovë 16-21 prill. Është ngjarja më e rëndësishme nga bibliotekaria që mbahet në Kosovë. Gjatë kësaj jave pati ligjërata shumë të rëndësishme nga ekspert të bibliotekarisë nga Amerika dhe Franca. Gjithashtu u

organizuan aktivitete të shumta kulturore si: promovime librash, ekspozita, orë letrare etj.

Në kuadër të kësaj jave biblioteka ndërkomunale “H. Sylejmani” bëri shpalljen e rezultateve të konkursit letrar. U dhanë nga katër shpërblime nga zhanret e ndryshme letrare: poezi, prozë, dramë dhe ese.

Gjithashtu gjatë javës së bibliotekës, me 20 prill, pati edhe një tryezë tematike nga bibliotekaria. Me ligjërata u paraqitën drejtorët e bibliotekave ndërkomunale të Kosovës.

- Me 3 prill në degën “Biblioteka Përkujtimore” janë mbajtur disa ligjërata profesionale nga mysafirët nga Shqipëria. Ligjëruese ishin Z. Shpresa Vreto drejtoreshë në Bibliotekën e Tiranës dhe Z.Flora Dervishi, drejtoreshë në Bibliotekën e Durrësit. Ato , bënë prezantimin e aktiviteteve të cilat i realizojnë në bibliotekat e tyre. Gjithashtu edhe Xhemail Luta bëri prezantimin e punëve të cilat realizohen në degët “Biblioteka Përkujtimore” dhe “Përralla”.Në këto ligjërata morën pjesë punëtorët e disa Bibliotekave ndërkomunale dhe komunale të Kosovës.
- Me 21-22 nëntor në BKUK u mbajt Konferenca e dytë për bibliotekonomi. Në këtë konferencë me tema u paraqitën profesionistë nga lëmi i bibliotekarisë nga Shqipëria dhe Kosova. Pati tema të larmishme dhe me interes nga kjo fushë dhe u përcollën nga punëtorët e të gjitha bibliotekave të Kosovës. Nga biblioteka jonë me temë u paraqit drejtori Sylejman Pireva. Kjo konferencë do të jetë tradicionale dhe vitin e ardhshëm do të mbahet në Tiranë.
- Pjesëmarrja e punëtorëve të bibliotekave ndërkomunale në Panairin e librit në Tiranë ishte një ngjarje tjetër me rëndësi. Ky grup punëtorësh mori pjesë në hapjen e Panairit dhe natyrisht sipas mundësive blenë edhe libra për bibliotekat e veta.
- Me 27 dhjetor në Sallën e Leximit u mbajt manifestimi tradicional i shpalljes së lexuesve më të dalluar, dhuruesve më të njohur dhe librave më të lexuara për vitin 2007. Duke ju falënderuar Drejtoratit për Kulturë dhe Gjini të Komunës së Prishtinës e cila për 5 vjet me radhë ka financuar projektet tona, donatorëve dhe dashamirëve të librit, biblioteka ka arritur ta pasurojë fondin e saj të koleksioneve me literaturë të larmishme nga të gjitha fushat e shkencës e dijes. Kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të lexuesve nga viti në vit, në mesin e të cilëve ka lexues të pasionuar dhe të rregullt të cilët meritojnë të dallohen dhe të shpërblehen.

Një komision i përbërë nga Fatime Mehmetaj-kryetare
Xhemail Luta- anëtar dhe

Vjollcë Tuli – anëtare, pasi shqyrtuan propozimet nga sektorët dhe degët e bibliotekës zgjodhën lexuesit më të dalluar, dhuruesit më të njohur dhe librat më të lexuara për vitin 2007.

Sektori për fëmijë:

Lundrim Lluga kl. VII sh. F. “Elena Gjika”

Dega “Biblioteka Përkujtimore”

Gresa Zeka kl. VII sh. F. “Faik Konica”

Nga dega “Përrallat”

Erion Halimi kl. III sh. F. “H. Prishtina”

Nga dega “Lektyra”

Liron Morina kl. IV sh. F. “H. Prishtina”

Nga Sektori për të rritur:

Vitesa Beqiri kl. 11 gjimnazi i gjuhëve “Eqrem Çabej”

Basri Gashi- punëtorë(polic)

Mirënjohjet:

Në shenjë falënderimi për ata që përkrahën dhe ndihmuan në pasurimin e bibliotekës me koleksione të reja kemi përgatitur nga një mirënjohje dhe nga një dhuratë modeste.

Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës që financoi projektin me vlerë 13.133 euro, me 447 tituj, 3148 ekzemplarë

Shtypshkronja “Verona” që i dhuroi bibliotekës 209 libra

Jusuf Buxhovi gjithashtu dhuroi 107 libra

Një mirënjohje kemi përgatitur edhe për kolegun tonë të nderuar Veli Veliun, i cili ka qenë i respektuar në mesin e punëtorëve dhe kontribuar shumë gjatë kohës që punoi në bibliotekë.

Librat më të lexuara:

Meri Poup Osborn- kompleti i veprave

J. K. Roëling: Harry Potter

Eleanor H. Porter: Poliana

Ismail Kadare –vepra

Dan Broën- vepra

Dale Carnegie- Psikologjia e suksesit 1-3

Takimet me shkrimtarë dhe krijues

Këtë vit u mbajtën disa takime me krijues në degën „Biblioteka Përkujtimore“ dhe në degën „Përrallat“.

- Me 19 janar në sallën e degës “Biblioteka Përkujtimore” u mbajt një orë letrare me lexues të nacionaliteteve të ndryshme në Kosovë. Kjo orë letrare u organizua nga organizata CARE- internacional në bashkëpunim me bibliotekën Ndërkomunale të Prishtinës. Nxënësit lexuan poezitë e tyre në të dy gjuhët. Ishin prezent një poete e nacionalitetit serb Gordana Nikoliç. dhe poeti Veli Veliu të cilët bashkëbiseduan me poetët e vegjël përkitazi me punimet e tyre. Pjesëmarrja ishte bukur e madhe dhe u lexuan poezi me përmbajtje të ndryshme.
- Me 14 shkurt lexuesit e bibliotekës “Përkujtimore” vizituan kopshtin e fëmijëve SOS për tu njoftuar me punën dhe aktivitetin e këtij institucioni edukativ. Disa nga lexuesit kishin qenë në këtë institucion parashkollor dhe ndiheshin të emocionuar me këtë ritakim. U krijua një atmosferë e ngrohtë mes fëmijëve të cilët u inkuadruan në një aktivitet të përbashkët.

- Me 23 shkurt në ambientin “Biblioteka Përkujtimore” u bë incizimi i një emisioni për fëmijë me lexuesit e kësaj biblioteke. Shkrimtari i mirënjohur Gani Xhafolli e bëri prezantimin e librit “Abeteka” të shkrimtarit Demir Reshiti.
- Me 2 mars 2007 dega ”Biblioteka Përkujtimore” në bashkëpunim me degën “Përrallat” realizuan një takim me dramaturgun tonë të njohur Shaip Grabovci në ambientin e degës “Biblioteka Përkujtimore”. Me këtë rast ata përgatitën një pjesë nga libri me drama “Besimi i humbur” të Shaip Grabovcit të cilën e aktruan me shumë sukses lexuesit e të dy bibliotekave. Pasoj një komunikim i lirë i lexuesve me shkrimtarin përmes pyetjeve të tyre të shumta.
- Për nderë të festës së 7 marsit ditës së mësuesit dhe 8 marsit , ditës së nënës si zakonisht u përgatit një program i pasur në degën “Biblioteka Përkujtimore”. Lexuesit u paraqitën me punimet e tyre artistike dhe 3 më të mirët u shpërblyen me nga një libër.
E ftuar nderi ishte mësuesja veterane zonja Sofije Kllokoqi, mësuese në shk. f. “Meto Bajraktari” e cila foli para të pranishmëve për punën e saj shumëvjeçare në këtë profesion të shenjtë. Me këtë rast lexuesit kishin përgatitur një program të pasur kulturor.
- Biblioteka Ndërkomunale “Hivzi Sylejmani” në bashkëpunim me Karvanin e shkrimtarëve, për herë të tretë, kremtoi 2 prillin, Ditën ndërkombëtare të librit për fëmijë e të rinj që u mbajt në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Pjesëmarrës ishin një delegacion nga Shqipëria me shkrimtaren e njohur Shpresa Vreton, udhëheqëse e IBBY në Shqipëri dhe drejtoreshë e bibliotekës publike të Tiranës, drejtoresha e bibliotekës publike të Durrësit zonja Flora Dervishi me disa kolegë, personalitete të njohura nga institucionet kulturore në Kosovë si dhe fëmijë të moshave të ndryshme. Hapjen e manifestimit e bëri drejtori i bibliotekës Ndërkomunale “H. Sulejmani” Sylejman Pireva i cili foli për historikun kësaj date si dhe mundësinë e anëtarësimit të Kosovës në IBBY.
Në vazhdim u lexua mesazhi “ Tregimet zgjojnë botën”. Këtë vit sponsor i IBBY-së ishte Zenlanda e Re. Mesazhin “ Tregimet zgjojnë botën” e ka shkruar shkrimtarja Margaret Mahy kurse posterin me këtë temë e ka ilustruar Zak Ēaipara. Pastaj shkrimtarja e njohur Shpresa Vreto foli për rëndësinë e Ditës Ndërkombëtare të librit për fëmijë e të rinj si dhe aktivitetet e ndryshme që mbahen me këtë rast nëpër vende të ndryshme të botës që janë anëtare të IBBY-së. Ajo i njoftoi të pranishmit se Shqipëria është anëtare e IBBY-s që nga viti 1992. Karvani i shkrimtarëve kryesuar nga Agim Deva lexuan pjesë letrare të cilat u mirëpritën nga pjesëmarrësit e sidomos nga fëmijët.
Pjesëmarrja e fëmijëve nga shkolla të ndryshme të Prishtinës të cilët janë njëkohësisht lexues të bibliotekës ishte e mirëseardhur. Ata lexuan punimet e tyre letrare të cilat ishin në nivel të lartë artistik.

- Me 24 o4. 2007 një grup fëmijësh nga kopshti i fëmijëve SOS vizituan degën “Biblioteka Përkujtimore” ku u pritën me ngrohtësi nga personeli i bibliotekës si dhe nga lexuesit e kësaj biblioteke të cilët kishin përgatitur një program modest me pika muzikore. Gjithashtu përgjegjësja e kësaj biblioteke u lexoi mysafirëve një tregim të autorit T. Gjonkutaj si dhe i njoftoj me aktivitetet që bëhen në këtë bibliotekë.
- U mbajt një takim me prindër të parashkollorëve në Bibliotekën Përkujtimore, përkritazi me njoftimin e tyre për mënyrën si punohet me ta dhe për çështje të tjera.

Punët dhe shërbimet teknike (financiare, administrative, të furnizimit, mirëmbajtjes, rojës etj.)

- Janë punë të kryera brenda Sektorit të Financave dhe të adnibistratës. Punët që kreu ky sektor janë ndër më të ndryshmet. Janë evidencuar të gjitha hyrje-daljet e mjeteve materiale, si nga anëtarësimi i lexuesve, ashtu edhe mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës. U bë kalkulimi dhe regjistrimi i të gjitha faturave dalëse të këtyre mjeteve, është përgatitur raporti financiar çdo tre muaj dhe është dërguar në Ministrinë e Kulturës.
- Janë evidencuar dhe sistemuar të gjitha dokumentat zyrtare. Është bërë furnizimi i të gjithë sektorëve dhe degëve me material bibliotekar dhe të pastrimit.
- Është intervenuar në raste të ndryshme për riparimin e defekteve të paraqitura dhe kujdesur për mirëmbajtjen e objektit të vjetëruar në të gjitha degët.
- Ky sektor është kujdesur edhe për mbajtjen e evidences së përditshme të ardhjes në punë, si dhe pranimit dhe ruajtjes së dokumentacionit nga pushimet vjetore dhe mjekësore.
- Ky Sektor është kujdesur edhe për punën e pastrimit të objektit të bibliotekës dhe të degëve të saj.

Aktiviteti i Klubit të Letrarëve të Rinj “Prishtina” të Bibliotekës

- Mbajtja e orës letrare me rastin e shpalljes së rezultateve të Konkursit letrar, nga krijuesit e shpërblyer dhe konkurruesit e tjerë;
- Klubi letrar “Oaza” organizoi një takim me disa anëtarë të vet me qëllim njoftimi me dy krijues anglezë që kishin shfaqur dëshirën për t’u bërë anëtarë të kësaj biblioteke dhe të këtij klubi. Ishte arritur marrëveshja që pranimi i tyre në Klubin letrar të Bibliotekës të bëhet disa ditë më vonë në mënyrë solemne dhe me një orë letrare, me pjesëmarrje edhe nga klube të tjera, si nga Besiana, Kastrioti etj.
- Me një Ore letrare të përgatitur nga klubi letrar i bibliotekës, në mënyrë solemne u bë pranimi si anëtarë të bibliotekës dhe të klubit letrar të Robert Eiltonit këshilltar i kryeministrit Çeku dhe Elizabet Goëing bashkëpunëtoresh kulturore. Kjo orë letrare u mbajt në lokalet e degës “Biblioteka Përkujtimore”. Me këtë rast lexuan punimet e tyre letrare anëtarët e klubit letrar të bibliotekës si dhe të klubeve tjera të ftuara në këtë orë letrare.

- Me rastin e 10 vjetorit të vdekjes së poetit dhe shkrimtarit tonë të njohur Azem Shkreli, biblioteka në bashkëpunim me klubin letrar të bibliotekës “Prishtina” organizuan një tribunë letrare. Pati të ftuar personalitete të njohura nga kultura si dhe familjarët e poetit. Fjalën e hapjes e mbajti drejtori Sylejman Pireva, kurse me tema u paraqitën prof. Agim Vinca i cili bëri një vështrim të përgjithshëm për poezinë e Azem Shkrelit. Për prozën në përgjithësi foli Basri Qapriqi, ndërsa me nga një temë interesante për veprimtarinë e Azem Shkrelit folën edhe Agim Apolloni dhe Betrat Dakaj, anëtarë të klubit letrar “Prishtina”. Në fund të takimit aktori i njohur Sylejman Lokaj interpretoi pjesë nga vepra e këtij autori.

Botimet:

- revista letrare “Oaza” nr. 1/Viti IV

Promovimet:

- Me 9 maj 2007 në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës u promovua libri i Gëzim Aliut, anëtarë i Klubit letrar të bibliotekës “Prishtina”, me titull “Diskurset e ideve në prozën e Kadaresë”. Për librin folën Zejnullah Rrahmani dhe Adil Olluri të cilët e vlerësuan lartë këtë libër.

Ekspozitat:

- Më 27 shtator u hap ekspozita e librit me titull “Libri i ri më 2007”, financuar nga Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës. Ekspozita qëndroi e hapur për dy ditë në sallën e leximit në Bibliotekën qendrore dhe u vizitua nga grupe nxënësish të shkollave të Prishtinës. Atyre iu fol për pasurimin e vazhdueshëm të koleksioneve të Bibliotekës dhe u ftuan që të bëhen anëtarë të saj se është në interesin e tyre.
- Herë pa herë ka pasur ekspozita të punimeve të lexuesve në degët e bibliotekave ku punohet me fëmijë, ë të cilat janë ekspozuar në ambientet e bibliotekës.

Hapja e bibliotekave të reja

- Gjatë këtij viti me përkrahjen e Drejtorisë për Kulturë dhe Gjini të Komunës së Prishtinës u bë rihapja e bibliotekës në sh. F. “Nexhmi Mustafa” në Besi ku biblioteka ndau një sasi librash me 115 tituj dhe 628 kopje. Kjo sasi librash u përpunua nga stafi i bibliotekës sonë.
- 2- 17 tetor një ekip i bibliotekës i përbërë nga 5 veta punuan në klasifikimin fondeve të bibliotekës së shk. Fill.”Dardania” e cila sipas marrëveshjes gojore mes dy drejtorëve dhe drejtorit të Drejtoratit për Kulturë dhe Gjini të Komunës së Prishtinës, do të jetë degë e bibliotekës sonë. Është bërë përpunimi fizik, klasifikimi i librit kurse inventarizimi është duke vazhduar nga punëtorja e kësaj

biblioteke. Ka mbetur të bëhet edhe radhitja e fondeve në raftet. Për këtë bibliotekë janë ndarë një fond i librave me vlerë 3000 euro me 491 tituj dhe 1751 kopje, që u financua nga Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës.

Renovimet dhe pajisja me inventar

Gatë këtij viti dega e bibliotekës në Pallatin e Rinisë është paisur edhe me 54 karrige të reja për studentët. IZUM(Instituti i shkencave informatike i Mariborit të Sllovenisë i dhuroi bibliotekës 5 kompjuterë hp dhe një printer. Në degën “Biblioteka Përkujtimore” u bë renovimi i një pjese të bibliotekës. Gjithashtu edhe në qendër është bërë zgjerimi i bufesë për punëtorët.

**Prishtinë,
28 dhjetor 2007**

**Drejtori,
Sylejman Pireva**